

PROCESVERBAL
nga seanca e 12-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 19.03.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, dr. Metodija Jançeski, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, Goran Radunoviq, Ivona Mufisheva, Emilija Janevska, Magdalena D. Dovleva, Aleksandar Xhuvarevqi, Maja Damevska.

Të pranishmit e tjerë:/

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski hapi seancën e 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 12:30 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Z. Petrushevski shpjegoi se do të bëjë korrigjim në Rendin e ditës të propozuar, përkatësisht Pika nën Të ndryshme - Propozim-vendim për dhënien e ndihmës financiare - donacion për qytetarët e prekur nga zjarri në Koçan do të zhvendoset si Pika 3. Dy pikat në vijim do të zhvendosen një numër më lart.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi të korrigjur si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 11-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 19.03.2025.
2. Propozim-vendim për dhënien e ndihmës financiare - donacion Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevail SHPKNJP Tetovë dhe Propozim - marrëveshje për donacion.
3. Propozim-vendim për dhënien e ndihmës financiare - donacion për qytetarët e prekur nga zjarri në Koçan.
4. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Larje automjetesh.
5. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë, për shkaqe teknike, ka shtyrë Propozim-procesverbalin e seancës së 11-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 19.03.2025, dhe njoftoi se do të shqyrtohet në vazhdimin e seancës së 12-të.

Pikat 2 dhe 3

Z. Trajçevski dha shpjegim për dy donacionet e propozuara. Ai sqaroi se donacioni i parë në shumë prej 500.000,00 denarë është destinuar për sanimin e pasojave nga zjarri i cili më 08.03.2025 përfshiu pjesë të objekteve të transmetuesit, ndërsa donacioni i dytë është 1.500.000,00 denarë, si ndihmë për qytetarët e prekur në aksidentin e tmerrshëm - zjarri që ka ndodhur më 16.03.2025 në Koçan.

Z. Jançeski, duke marrë parasysh përmasat e tragjedisë dhe pasojat e saj, që tronditi thellë opinionin, sugjeroi që në Vendimin për donacion të përfshihet një dispozitë e shkurtër, e cila do të parashikon mundësinë e një donacioni shtesë nëse Agjencia realizon mjete më të mëdha financiare. Ai theksoi se kjo paraqet tragjedinë më të madhe në historinë e Maqedonisë dhe shprehu dëshirën që të ndërmerren të gjitha hapat e mundshme për sigurimin e mjeteve shtesë, në mënyrë që Agjencia të dhurojë një donacion të dytë ose plotësimin e shumës tashmë të përcaktuar.

Z. Trajçev theksoi se ligjërisht është e mundur që kjo dispozitë të përfshihet në Vendim, por mund të merret edhe konkluzion i veçantë, me të cilin Agjencia do të obligohet, nëse siguron mjete shtesë, t'i ndajë për donacion.

Z. Petrushevski sugjeroi që propozimi i z.Jançeski të pranohet në formë Konkluzioni.

Këshilli nuk kishte vërejtje.

Votimi për pikën 2

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që drejtori i Agjencisë të marrë Vendim për dhënien e ndihmës financiare - donacion Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip SHPKNJP Tetovë, në shumë prej 500.000,00 (pesëqind mijë) denarë, për sanimin e pasojave nga zjarri i cili më 08.03.2025 përfshiu një pjesë në ambientet e transmetuesit, me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të transmetuesit për kryerjen pandërprerë të veprimtarisë së tij - transmetimin e programeve televizive dhe përmbajtjeve me rëndësi për rajonin D8 – Kodra e Diellit (Tetovë, Gostivar, Vrapçishtë, Bogovinë, Bërvenicë, Tearcë, Jegunovcë, Zhelinë), si dhe sigurin dhe mbrojtjen e punonjësve.

Mjetet financiare ndahen nga mjetet financiare të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025 dhe janë paraparë në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2025, dhe të njëjtat pagohen në llogarinë e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip SHPKNJP Tetovë numër: 2904000001362-19, deponent i TTK Bankës Tetovë, me numër tatimor 4028995108379.

Për dhënien e ndihmës financiare - donacion lidhet Kontratë për donacion ndërmjet Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip SHPKNJP Tetovë, e cila hyn në fuqi menjëherë pas

nënshkrimit nga të dyja palët kontraktuese, dhe do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Votimi për pikën 3

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që drejtori i Agjencisë të marrë Vendim për dhënien e ndihmës financiare - donacion në shumë të përgjithshme prej 1.500.000,00 (një milion e pesëqind mijë) denarë, si ndihmë për qytetarët e prekur (lënduar) në aksidentin e tmerrshëm - zjarri që ndodhi në Koçan më 16.03.2025, të cilin do ta zbatojë përmes Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si pranues i donacionit.

Pranuesi i donacionit do t'i shpërndajë mjetet e lartpërmendura financiare sipas nevojave të qytetarëve të prekur nga zjarri në Koçan.

Mjetet financiare janë ndarë nga mjetet financiare të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025 dhe janë të parapara në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2025, dhe pagohen në llogari të veçantë dedikuar Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut - Fondi i Solidaritetit Banka Komerciale SHA Shkup, numër i llogarisë 300000001327966, numër tatimor: 4030984271620, me shënim: ndihmë për qytetarët e prekur nga zjarri në Koçan.

Për dhënien e ndihmës financiare - donacion nga pika 1 e këtij Konkluzioni, lidhet Kontratë për donacion ndërmjet Agjencisë dhe Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dyja palët kontraktuese dhe do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur për dhënien e ndihmës financiare - donacion për qytetarët e prekur nga zjarri në Koçan më 16.03.2025 ta publikon në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi konkluzion, që gjatë vitit 2025 t'u jepet një donacion shtesë si ndihmë për qytetarët e prekur nga zjarri i tmerrshëm që ndodhi në Koçan më 16.03.2025, vetëm nëse Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ka mundësi financiare. Dhënia eventuale e donacioni shtesë do të realizohet pas vlerësimit të kryer të mundësive financiare të Agjencisë dhe rrethanave tjera.

Pika 4

Udhëheqësi i njësisë për furnizim publik, mr. Aleksandar Xhuvareviq, ka shpjeguar Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik shërbim: Larja e automjeteve. Ai shpjegoi se bëhet fjalë për furnizim me vlerë të vogël, e cila do të rezultojë me lidhje të Kontratës për një periudhë dyvjeçare. Furnizimi është dedikuar për

nevojat e Agjencisë, në mënyrë që të sigurohet përdorimi i pandërprerë i automjeteve zyrtare përmes pastrimit dhe mirëmbajtjes higjienike të tyre.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Larja e automjeteve.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Larja e automjeteve, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-5321/1 datë 27.12.2024, dhe mjetet sigurohen nga Planin financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025, përkatësisht do të parashikohen më tej nga Planin Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.

Pika 5

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**